

## SYLLABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	<b>Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit</b>
Titulli i lëndës:	Historia e Kosovës nga 1912 deri me sot
Niveli:	Histori Ed. Qytetare
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	VI-të
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Enjte 8:00-10:15
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Ethem Çeku
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:ethem.ceku@uni-pr.edu">ethem.ceku@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Ky kurs fokusohet në ngjarjet historiko-politike dhe ekonomike të Kosovës në shek. XX-XXI. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: Kongresi i Manastirit, Kryengritjet e Mëdha të Kosovës në vitet 1910, 1911, 1912, Shpallja e Pavarsisë së Shqipërisë, Kosova pas konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe Raportet Diplomatike me Fuqitë e Mëdha, Kosova gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, Çështja e Kosovës në Konferencën e Versajës, gjendja e Shqiptarëve të Kosovës pas Krijimit të Mbretërisë SKS, Lufta e Dytë Botërore – pasojat dhe rrjedhat politike në Kosovë, pozita e re Juridike dhe Kushtetuese e Kosovës, lëvizjet ilegale në Kosovë 1968-1981, Kosova gjatë viteve 1981 - 1989, Pluralizmi në Kosovë dhe Sistemi Paralel, Rezistenca Paqësore, Lufta e Armatosur për çlirimin e Kosovës, Çlirimi i Kosovës, Forcat paqëruajtëse dhe Organizatat Ndërkombëtare, Procesi i Integrimi Evropian. Studentët do të njohin historinë më të re të Kosovës, sfidat historike të popullit të saj dhe rrugëtimin që e ka Kosova drejt integritetit evropian.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p><b>Qëllimi:</b> Të marrin njohuri relevante mbi jetën, historinë dhe përpjekjet e shqiptarëve për mbijetesë dhe emancipim kombëtar. Të kuptojnë raportet me pushtuesit dhe fqinjët si dhe copëtimin e trojeve shqiptare.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Dallojnë konceptet themelore të Historisë</li></ul>

	<p>bashkëkohore të Kosovës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruajnë gjendjen e shqiptarëve të Kosovës dhe përpjekjet shtetëformuese të saj gjatë Historisë Bashkëkohore;</li> <li>• Kuptojnë rolin dhe ndikimin e levizjeve politike të Kosovës në mbarë hapsirën shqiptare në periudhën Bashkëkohore;</li> <li>• Analizojnë marëdhëniet diplomatike të Kosovës me fqinjët dhe shtetet e zhvilluara perëndimore;</li> <li>• Vlerësojnë rolin e levizjeve ilegale në shtetformimin e Kosovës;</li> <li>• Krahasojnë lëvizjen paqësore dhe luftën e armatosur;</li> <li>• Njohin zhvillimet politike dhe ekonomike pas çlirimit;</li> </ul> <p>Zhvillojnë një mini-projekt (seminar) hulumtues që ka të bëjë me rolin që luajti bashkësia ndërkombëtare në çlirimin e Kosovës dhe zhvillimin e shtetit të Kosovës.</p>
--	--

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Projektet,prezentimet ,etj	1	15	15
<b>Totali</b>			<b>125</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjerata përmes prezantimeve në power point, puna në grupe si dhe angazhimi i studentëve me punë seminarike.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë: 25%, Vlerësimi i dytë 25%, Prezentimi dhe seminarët 10% dhe provimi final 40% (test apo me metodë klasike të të pyeturit verbal).
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Malcolm, Noel. Kosova një Histori e Shkurtër. Prishtinë, 2001;</li> <li>2. ASHSH, IH. Historia e Popullit Shqiptar. Tiranë, 2002;</li> <li>3. Çeku, Ethem. Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe Shqipërisë, Prishtinë, 2009;</li> <li>4. Çeku, Ethem. Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981. Prishtinë, 2003;</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Schëartz, Stephen. Kosova- prejardhja e një lufte. Prishtinë, 2006;</li> <li>2. Lory, Bernard. Evropa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona. Tiranë, 2007;</li> <li>3. ASHAK, Kosova, Vështrim Monografik. Prishtinë, 2011;</li> <li>4. Clayer, Nathalie . Në fillimet e nacionalizmit Hadri, Ali. Marëdhënit shqiptaro-jugosllave. Prishtinë, 2003;</li> <li>5. Judah, Tim. Kosovo: Ëar and Revenge , London 2000;</li> <li>6. Mixhel, Roux. Le Kossovo: Dix Cles pour comprendre, la decouverte . Paris, 1999.</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Luftrat Ballkanike, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vendimet e saja për Kosovën.
<b>Java e dytë:</b>	Kosova gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, Çështja e Kosovës në Konferencën e Versajës,
<b>Java e tretë:</b>	gjendja e Shqiptarëve të Kosovës pas Krijimit të Mbretërisë SKS.
<b>Java e katërt:</b>	Kaçakët dhe kolonistët 1918-1941
<b>Java e pestë:</b>	Lufta e Dytë Botërore – pasojat dhe rrjedhat politike në Kosovë.
<b>Java e gjashtë:</b>	Kosova pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova nën Titon.
<b>Java e shtatë:</b>	Projektet serbe për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova
<b>Java e tetë:</b>	Testi i I-rë

<b>Java e nëntë:</b>	Pozita Juridike dhe kushtetuese e Kosovës. Kushtetuta e Kosovës 1974. Libri i kaltër serb.
<b>Java e dhjetë:</b>	Zhvillimi ekonomik social dhe kulturor i Kosovës. Universiteti i Prishtinës
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Lëvizja ilegale në Kosovë 1968-1981
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Kosova nga Viti 1981-1989
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Kosova nga viti 1989 deri në Luftën e UÇK-së
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Rrugëtimi i Kosovës drejt aderimit në BE
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Testi i Dytë

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentet janë të obliguar në pjesëmarrje të rregullt në ligjerata, ardhje me kohë dhe mbajtje e qetësisë në mësim si dhe çkyqja e telefonave celular. Gjatë mbajtjes së testeve ndalohen bisedimet, kopjimi apo format e tjera të pengimit të punës.